



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2024:052735

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05449102

P.nr.63/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, sekretares juridike Rukije Matoshi, në çështjen penale ndaj të pandehures M. S.-Z. nga fsh. H. i M., të cilën e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.114/24F të dt.14.02.2024, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar, jopublik, të mbajtur me datën 12.03.2024, në prani të prokurorit të shtetit Besnik Jakupi, të pandehurës dhe të të dëmtuarit A. S. nga fsh. H. i M., me datë 14.03.2024 muarr dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurës:

M. S. – Z., lindur me datë ..., në fsh. B. i M. në L., me vendbanim ne fsh. H. i M., ku edhe tani jeton, nga i ati F., nënës A., e gjinisë G., e martuar nënë e dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin ekonomik dhe te edukimit, e gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, mbrohet ne liri.

Ë S H T Ë F A J T O R E

S E P S E

Me datë 28.01.2024, rreth orës 22:00^h, në shtëpinë e tyre të përbashkët në shatin H. i M., në L., e pandehura M. S. –Z., me dashje dhe më qëllim që ta sulmoj dhe të cenimit të dinjitetit në marrëdhënien familjare ka ushtruar dhunë fizike ndaj të dëmtuarit – burrit të saj A. Z., pasi që e dëmtuara është punësuar si mësimdhënëse, i dëmtuari ka kërkuar nga e pandehura pasi që tani je punësuar me kontribuj ne shtëpi 60% nga te ardhurat që merr si mësimdhënëse, e dëmtuara ka refuzuar dhe pas fjalosjes ka shkuar në dhomën e saj, e ka telefonuar vëllain e saj dhe i ka thënë “hajde merrem se me ka larguar A.” dhe ka filluar ti marr rrobat e veta dhe arin, aty ka ndërhyre i dëmtuari nuk ka desh që t’ia jap arin dhe janë kapur për kutije, atëherë e pandehura e ka sulmuar të dëmtuarin me shkelma disa herë ne bark e duke e rrezuar ne dysHEME, pa i shkaktuar lëndime trupore,-

- me këtë e ka kryer veprën penale Sulmi, nga neni 184 par.1 të KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 81, 82, dhe neni 184 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Të pandehures M. S. –Z., i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën veprë penale, dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do ti shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

I dëmtuari: A. S. nga fsh. H. i M., udhëzohet që kërkesën pasuroro-juridike ta realizoj në procedurë të rregullt civile.

DETYROHET e pandehura që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajnë paushallit gjyqësor shumën prej 50-€, si dhe shumën nga 20-€, në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.114/24F të dt.14.02.2024, e ka akuzuar të pandehuren M. S. –Z. nga fsh. H. i M., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehures pasi që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe konformë nenit 242 të KPPK-së, pasi që edhe vetë pranimi i fajësisë është në mbështetje të plotë në të gjitha faktet që i përmban aktakuza si dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjten ta shpallë fajtores dhe ta dënojë sipas ligjit.

E pandehura ne senancen fillestare ka deklaruar se e pranonë fajsinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe njëherit ka shtuar se është nënë e dy fëmijëve, më parë asnjher nuk ka ra ndesh me ligjin është mbajtëse e familjes, është mesimdhënëse në Sh.F. në "B.", mosmarrëveshjen që e kanë pasur qenë e atëqasëshme dhe ato i kanë tejkaluar me bashkëshortin tani kanë harmoni në familje dhe ka kërkuar nga gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të but nga se edhe në të ardhmen ka premtuar që nuk do të përsëriten sjellje të tilla.

I dëmtuari në seancën fillestare ka dkelruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të pandehures dhe as nuk parashtonë kërkesë pasuroro juridike, vërtet ato mosmarrëveshje i kanë tejkaluar, ka qenë të atqasëshme dhe tani kanë raporte të mira mes veti, ka kërkuar që e pandehura të mos dënohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve të kundërligjshme, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konformë nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehures për veprën penale për të cilën akuzohet.

Matja dhe caktimi i dënimit

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehuren, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se e njëjta për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra, faktin se e njëjta është mesimdhënëse dhe në të ardhmen do të kontribuojë për shoqërinë dhe nënë e dy fëmijëve, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se e njëjta është penduar për veprën penale dhe me të dëmtuarin janë pajtuar dhe jetojnë bashkarisht duke i tejkaluar ato mosmarrëveshje dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëriten sjellje të tilla, si dhe faktin se i dëmtuari nuk i ka bashkangjitur ndjekejs penale, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehuren pra, faktin se në kohen e kryerjes së veprës penale e njëjta ka qenë e aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e ulët të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtes i shqiptoi vërejtje gjyqësore duke u bindur se me këtë sanksion penal do të arrihet qëllimi i vërejtjes gjyqësore i paraparë me nenin 81 të

KPRK-së, pra, që kryesës ti jepet qortimi dhe duke marrur parasysht rrethanat në lidhje me kryesën vërejtja gjyqësore është e mjaftushme për të arritur qëllimit të dënimit.

Shpenzimet e procedurës

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku shuma në emër të paushallit gjyqësor prej 20-€ u caktua në bazë të ndërlikshmërisë së procedurës penale ndërsa shuma prej 20-€ në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimin, u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

Kërkesa pasurore-juridike

Vendimi për kërkesën pasurore-juridike u bazua në nenin 462 të KPPK-së pasi që i dëmtuari nuk ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike në këtë procedurë penale.

Nga arsyet e cekura më lartë si dhe dispozitave të lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN
P.nr.411/23 dt.27.10.2023

Bashkëpunëtorja profesionale
Gentiana Dakaj

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.